



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 63

Tiranë – E premte, 24 prill 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 27/2015 datë 26.3.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar..... 2795
Ligj nr. 32/2015 datë 2.4.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 102/2014 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”..... 2798
Ligj nr. 34/2015 datë 2.4.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar..... 2798
Dekret i Presidentit nr. 9048, datë 16.4.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2804
Dekret i Presidentit nr. 9049, datë 16.4.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2804
Dekret i Presidentit nr. 9050, datë 16.4.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2805



LIGJ
Nr. 27/2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 8097, DATË 21.3.1996, “PËR
PENSIONET SHTETËRORE
SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË
KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE
DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

- Në pikën 7, fjalët “dhe e rillogaritjes” hiqen.
- Në pikën 8, shkronja “a”, pas fjalëve “Prokurori i Përgjithshëm” shtohen fjalët “Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.
- Në pikën 8, shkronja “b”, shtohen funksionet: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, “Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe “Gjeneralët e Forcave të Armatosura dhe punonjësit e Policisë së Shtetit të rolit madhor”.

4. Pas pikës 10 shtohen pikat 11 dhe 12 me këtë përmbajtje:

“11. Me termin “pagesë kalimtare” kuptohet pagesa që përfitojnë personat, subjekt i këtij ligji, pas ndërprerjes së funksionit ose kur punësohen në një funksion me pagë më të ulët se paga pararendëse.

12. Në kuptim të pikës 9, të këtij neni, institucionet qendrore buxhetore, që do të përfshihen në këtë skemë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5
Masa e kontributeve

Kontributet, që paguajnë personat e punësuar në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, janë:

- 5 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të parë;
- 4 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji;
- 3 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “d”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji.”.

Neni 3

Titulli i kreut II “Shpërblime dhe pensione” bëhet “Përfitimet”

Neni 4

Në nenin 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në paragrafin e parë, pas fjalëve “50 për qind e pagës referuese” shtohet fjala “bruto”.
- Në paragrafin e dytë, pas fjalëve “50 për qind e pagës referuese” shtohet fjala “bruto”.
- Në paragrafin e tretë, pas fjalëve “40 për qind e pagës referuese” shtohet fjala “bruto”.
- Në paragrafin e pestë, fjalët “shpërblim të menjëhershëm” zëvendësohen me fjalët “pagesë pas ndërprerjes së funksionit të fundit”.
- Paragrafi i shtatë ndryshohet si më poshtë:
“Në rastet kur gjatë trajtimit me pagesë kalimtare lind e drejta për një përfitim nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, përfituesi nga ky ligj ka të drejtën e zgjedhjes së njërit prej tyre.”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8
Kushtet e përfitimit për grupin e parë

Kushtet e përfitimit për personat e grupit të parë, sipas këtij ligji, janë:

- Të kenë mbushur moshën 60 vjeç ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit për sigurimet shoqërore të detyrueshme. Duke



filluar nga data 1.1.2032, mosha e përfitimit rritet me nga 6 muaj për çdo vit, deri në arritjen e moshës 63 vjeç.

2. Të kenë periudha të njohura shërbimi në një nga funksionet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 8, të nenit 1.

3. Të ketë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.”.

Neni 6

Neni 9 riformulohet si më poshtë:

“Neni 9

Masa e pensionit

Masa e pensionit shtetëror suplementar është:

a) për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, 25 për qind e pagës referuese, edhe nëse periudha e shërbimit është më e vogël se dy vjet, dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbimi mbi dy vjet;

b) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 8, të nenit 1, përjashtuar personat e përmendur në shkronjën “a”, të këtij neni, 25 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar në masën 1 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi;

c) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 8, të nenit 1, 20 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në masën 0,8 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi.

Masa e pensionit nuk duhet të jetë më e madhe se:

a) 60 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 1;

b) 50 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 1.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese mesatare të funksioneve.”.

Neni 7

Neni 10 riformulohet si më poshtë:

“Neni 10

Kushtet e përfitimit për grupin e dytë

Kushtet e përfitimit për personat e grupit të dytë, sipas këtij ligji, janë:

a) të kenë kryer 35 vite shërbimi në detyrat ose funksionet e parashikuara nga ky ligj; ose

b) të kenë arritur moshën për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ose

c) para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e sipërpërmendura, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.”.

Neni 8

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Masa e pensionit

Masa e pensionit shtetëror suplementar në kushtet e nenit 10 është:

a) për personat e grupit të dytë, sipas shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,5 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

b) për personelin drejtues të grupit të dytë, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,3 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

c) për personelin specialist të grupit të dytë, sipas shkronjës “d”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,1 për qind në vit e pagës referuese, për çdo vit shërbimi.

Pensioni shtetëror suplementar maksimal, sipas këtij neni, nuk duhet të jetë më i madh se 40 për qind e pagës referuese.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese të funksionit.”.



Neni 9

Në nenin 15 bëhen këto shtesa:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalëve “vitet e punuara” shtohen fjalët “në funksionet apo detyrat e përcaktuara nga ky ligj”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Procedurat dhe institucionet kompetente për njësimin e funksioneve dhe të pagës referuese, kur emërtimet e funksioneve kanë ndryshuar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Paga referuese, për efekt të llogaritjes së pensionit suplementar, sipas këtij ligji, për deputetët e legjislaturës 1991-1992, që në të njëjtën kohë punonin në funksione dhe detyra të tjera, do të jetë paga referuese e deputetit, në momentin e daljes së tyre në pension.”.

Neni 10

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Indeksimi

Pensionet shtetërore suplementare indeksohen. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

E drejta për përfitim

E drejta për përfitim shtetëror suplementar nuk parashkruhet.

Personit, që kërkon përfitim shtetëror suplementar brenda një viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky përfitim që nga kjo datë. Në raste të tjera, përfitimi do të paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.

Përfitimet e njohura nga ky ligj, por të patërhequra, do të paguhet në çdo kohë, por jo më shumë se tre vjet.

Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet.

E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se tre vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se gjashtë muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës, për çdo muaj, është 20 për qind e kështit mujor të përfitimit.”.

Neni 12

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1

Të drejtat e fituara

Pensionet shtetërore suplementare me datë fillimi deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfshirë edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rillogaritjeje, përveç indeksimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

Personat, që kanë fituar të drejtën për pension shtetëror suplementar në moshën 55 vjeç e lart, do të vazhdojnë të paguhet, pavarësisht se nuk e kanë arritur moshën e përcaktuar në këtë ligj.

Personat, që janë trajtuar me pension shtetëror suplementar dhe e kanë ndërprerë atë për arsye punësimi, kanë të drejtën e rikthimit në skemën e pensioneve suplementare edhe përpara moshës 60 vjeç.”.

Neni 13

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Pensioni shtetëror suplementar ndërpritet vetëm me vendim gjykate të formës së prerë dhe, në këtë rast, vendoset edhe për kthimin e kontributeve.”.

Neni 14

Neni 25 riformulohet si më poshtë:

“Neni 25

Pensioni shtetëror suplementar, sipas këtij ligji, përfitohet edhe në rastet kur personi përfiton pension të posaçëm shtetëror, pension nga një skemë tjetër suplementare ose trajtim të veçantë, me kusht që periudhat e shërbimit të mos mbivendosen.”.

Neni 15

Neni 29 riformulohet si më poshtë:

“Neni 29

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1, 15 dhe 17 të këtij ligji.



2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave të nxjerrin aktin nënligjor të përbashkët për procedurat e pagimit të kontributeve dhe të përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj.”

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.3.2015

Shpallur me dekretin nr. 9051, datë 20.4.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**LIGJ
Nr. 32/2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 102/2014 “KODI
DOGANOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 213, pika 2, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Magazinat doganore private konsiderohen edhe “dyqane të çliruara nga detyrimet” (duty free shops) që autorizohen të hapen në aeroportet për fluturime ndërkombëtare, portet për destinacionet ndërkombëtare dhe pikat kufitare tokësore, që ndodhen në zonën doganore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat, rregullat, mënyrën dhe kriteret e dhënies dhe numrin e autorizimeve për “dyqanet e çliruara nga detyrimet” (duty free shops), si dhe kushtet, të drejtat, detyrimet dhe afatet.”

Neni 2

Në nenin 289, pika 2, pas numërimit “16” shtohen fjalët “pikat 4 dhe 5 të nenit 199”.

Neni 3

Në nenin 291, pika 2, pas fjalëve “dhe 288” shtohen fjalët “fjalja e dytë e pikës 2 të nenit 213”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9052, datë 20.4.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**LIGJ
Nr. 34/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
RUMANISË PËR MBROJTJEN E
NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9053, datë 20.4.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË MBI MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Rumanisë, më poshtë quhen “Palët”, *me synim* sigurimin e mbrojtjes reciproke të informacionit të klasifikuar, për të cilin është caktuar një nivel i klasifikimit të sigurisë në shtetin e një Pale dhe i është transferuar shtetit të Palës tjetër,

me dëshirën për të vendosur rregulla për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, që do të shtrihet te të gjitha marrëveshjet mbi bashkëpunimin që do të lidhen ndërmjet Palëve dhe kontratat që do të jepen ndërmjet subjekteve juridike publike dhe private të shteteve të Palëve, që parashikojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Kjo Marrëveshje përbën bazën ligjore të çdo aktiviteti që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Palëve në lidhje me çështje, si:

a) bashkëpunimi ndërmjet Palëve në lidhje me mbrojtjen kombëtare dhe çdo çështje tjetër në lidhje me sigurinë kombëtare;

b) bashkëpunimi, ndërmarrjet e përbashkëta, kontratat dhe çdo marrëdhënie ndërmjet organeve shtetërore ose subjekteve të tjera ligjore publike ose private të Palëve në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe çdo çështje tjetër në lidhje me sigurinë kombëtare;

c) shitjet e pajisjeve, produkteve dhe ekspertizës.

2. Secila Palë nuk i referohet kësaj Marrëveshjeje për të përfutuar informacion të klasifikuar që Pala tjetër e ka marrë nga një Palë e tretë.

3. Kjo Marrëveshje nuk cenon detyrimet e të dyja Palëve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe nuk përdoren kundër interesave, sigurisë dhe integritetit territorial të shteteve të tjera.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Informacion i klasifikuar” është çdo informacion, dokument ose material, që, pavarësisht nga forma e tij, kërkon mbrojtje kundrejt deklarimit ose asgjësimit të paautorizuar, keqpërdorimit, dëmtimit ose humbjes, dhe është përcaktuar si i tillë sipas legjislacionit të shtetit të një Pale;

b) “Kontratë/nënktratë e klasifikuar” është një kontratë/nënktratë që përmban ose përfshin akses në informacionin e klasifikuar;

c) “Nivel i klasifikimit të sigurisë” është një kategori, e cila, sipas legjislacionit të brendshëm, tregon rëndësinë e informacionit të klasifikuar dhe që përcakton kufizime të caktuara të aksesit në të, masat e mbrojtjes dhe të shënjitjes;

d) “Shkelja e sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm ose rregulloret e sigurisë të njërit prej Palëve, që rezulton ose mund të rezultojë në deklarimin ose asgjësimin e paautorizuar, keqpërdorimin, dëmtimin ose humbjen e informacionit të klasifikuar.

e) “Certifikatë sigurie personeli” është një dokument që rrjedh nga një procedurë verifikimi që shërben për të përcaktuar besnikërinë dhe besueshmërinë e një personi, për të afirmuar përputhshmërinë me kushtet e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm, mbi bazën e të cilit mund t’i jepet këtij personi akses tek informacioni i një niveli të caktuar klasifikimi sigurie;

f) “Certifikatë sigurie industriale” është një dokument që jepet nga autoriteti kompetent i sigurisë që shërben për të përcaktuar aftësinë e një subjekti ligjor për të marrë pjesë në aktivitete parakontraktuale, ose të përmbushë kontrata/nënkontrata të klasifikuara, në pajtim me legjislacionin përkatës kombëtar;

g) “Pala e origjinës” është Pala duke përfshirë subjektet ligjore publike dhe private të shtetit të Palës që jep informacion të klasifikuar;

h) “Pala marrëse” është Pala, duke përfshirë subjektet ligjore publike dhe private të shtetit të Palës, që merr informacion të klasifikuar;

i) “Palë e tretë” është çdo shtet, organizatë ndërkombëtare, subjekt ligjor publik ose privat që nuk është palë në këtë Marrëveshje.



Neni 3

Nivelet e klasifikimit të sigurisë

Palët kanë përcaktuar që ekuivalenca e niveleve kombëtare të klasifikimit të sigurisë është si më poshtë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Ekuivalenti në anglisht	Për qeverinë e Rumanisë
TEPËR SEKRET	TOP SECRET	STRICT SECRET DE IMPORTANȚĂ DEOSEBITĂ
SEKRET	SECRET	STRICT SECRET
KONFIDENCIAL	CONFIDENTIAL	SECRET
I KUFIZUAR	RESTRICTED	SECRET DE SERVICIU

Neni 4

Autoritetet kompetente të sigurisë

1. Autoritetet kompetente të sigurisë të shteteve të Palëve të pajisura me autoritetin e zbatimit të masave mbrojtëse për informacionin e klasifikuar janë:

Në Republikën e Shqipërisë	Në Rumani
Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar - në varësi të Kryeministrit (Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar - Zyra e kryeministrit)	Guvernul României Oficiul Registrului Național al Informațiilor Secrete de Stat Qeveria e Rumanisë Zyra Kombëtare e Regjistrat për Informacionin e Klasifikuar

2. Autoritetet kompetente të sigurisë njoftojnë njëri-tjetrin në lidhje me ndryshimet përkatëse në të dhënat zyrtare të kontaktit.

Neni 5

Aksesi në informacionin e klasifikuar

1. Aksesi në informacionin e klasifikuar KONFIDENCIAL/CONFIDENTIAL/SECRET ose mbi të është i lejuar tek ata persona të cilët, me qëllim që të përmbushin funksionet ose detyrat e tyre, duhet të kenë akses te ky informacion dhe janë pajisur me certifikatat përkatëse të sigurisë së personelit.

2. Aksesi në informacionin e klasifikuar I KUFIZUAR / RESTRICTED / SECRET DE SERVICIU është i lejuar tek ata persona, të cilët, me qëllim që të përmbushin funksionet ose detyrat e tyre, duhet të kenë akses te ky informacion dhe me kusht që të përmbushin kërkesat për akses te ky informacion i klasifikuar, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palëve.

3. Pala marrëse:

a) nuk i jep informacion të klasifikuar një Pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së origjinës;

b) i jep të gjithë informacionit të klasifikuar të marrë të njëjtën mbrojtje siç parashikohet për informacionin e klasifikuar të brendshëm me nivelin ekuivalent të klasifikimit të sigurisë, sipas nenit 3;

c) nuk e përdor informacionin e klasifikuar për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është dhënë;

d) respekton të drejtat e pronësisë intelektuale që përfshijnë informacion të klasifikuar;

e) nuk ia ul nivelin dhe nuk e deklasifikon informacionin e klasifikuar të marrë pa pëlqimin paraprak me shkrim ose pa kërkesë të Palës së origjinës.

Neni 6

Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar transmetohet me kanale diplomatike, korrierë ushtarakë ose mjete të tjera të rëna dakord nga autoritetet kompetente të sigurisë. Autoriteti kompetent i sigurisë i Palës marrëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Nëse duhet të transmetohet një paketë e madhe që përmban informacion të klasifikuar,



autoritetet kompetente të sigurisë bien bashkërisht dakord dhe aprovojnë mjetet e transportit, itinerarin dhe masat e sigurisë për secilin rast.

3. Transmetimi elektromagnetik i informacionit të klasifikuar kryhet vetëm në formë të koduar me mjete kriptografike të certifikuar dhe të miratuara nga autoritetet kompetente të sigurisë.

4. Pala e origjinës informon Palën marrëse për kushtet shtesë të dhënies ose kufizimet për përdorimin e informacionit të klasifikuar të transmetuar.

Neni 7

Shënjimi i informacionit të klasifikuar

1. Pala marrëse shënjon informacionin e klasifikuar të transmetuar nga Pala e origjinës me nivelin përkatës të klasifikimit të brendshëm të sigurisë, sipas ekuivalencës të përcaktuar në nenin 3.

2. Riprodhimet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të marrë shënjohehen dhe trajtohen në të njëjtën mënyrë, si dhe origjinalet.

3. Kërkesat për shënjim zbatohen edhe për informacionin e klasifikuar të gjeneruar në lidhje me një kontratë/nëkontratë të klasifikuar.

4. Pala e origjinës njofton palën marrëse në lidhje me çdo ndryshim në nivelin e klasifikimit të sigurisë të informacionit të klasifikuar të transmetuar.

Neni 8

Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni TEPËR SEKRET/TOP SECRET/STRICT SECRET DE IMPOR-TANË DEOSEBITË lejohet për përkthim dhe riprodhim vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të autoritetit kompetent të sigurisë së shtetit të Palës së origjinës.

2. Në rastin e riprodhimit të informacionit të klasifikuar, riprodhohet edhe niveli origjinal i klasifikimit të sigurisë.

3. Të gjitha përkthimet e Informacionit të klasifikuar bëhen nga personat që kanë certifikata sigurie personeli. Përkthimi shënjohehet me të njëjtin nivel të klasifikimit të sigurisë si origjinali, dhe mban një shënim të përshtatshëm në gjuhën në të cilën është përkthyer, që përkthimi përmban informacion të klasifikuar të Palës së origjinës.

4. Të gjitha riprodhimet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar vendosen sipas të njëjta masave mbrojtëse, si dhe informacioni origjinal. Numri i kopjeve kufizohet tek ai që kërkohet për qëllime zyrtare.

Neni 9

Asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar asgjësohet në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palës marrëse, në mënyrë të tillë që të eliminohet rindërtimi i pjesshëm ose i plotë.

2. Informacioni i klasifikuar mund të asgjësohet vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim ose me kërkesë të Palës së origjinës.

3. Pala marrëse njofton me shkrim Palën e origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

4. Informacioni TEPËR SEKRET/TOP SECRET/STRICT SECRET DE IMPOR-TANË DEOSEBITË nuk asgjësohet por i kthehet Palës së origjinës.

5. Në rastin e një situatë që e bën të pamundur mbrojtjen dhe kthimin e informacionit të klasifikuar të gjeneruar ose të transmetuar sipas kësaj Marrëveshjeje, informacioni i klasifikuar asgjësohet menjëherë. Pala marrëse njofton me shkrim dhe në kohën e duhur Palën e origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

Neni 10

Bashkëpunimi për sigurinë

1. Palët njohin reciprokisht certifikatat e sigurisë së personelit dhe certifikatat e sigurisë industriale të lëshuara për shtetasit dhe subjektet ligjore për shtetet e tyre, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm në lidhje me aksesin në informacionin e klasifikuar të shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet kompetente të sigurisë njoftojnë njëri-tjetrin në lidhje me ndryshimet në certifikatat e sigurisë së personelit dhe certifikatat e sigurisë industriale, të cilat janë të lidhura me aktivitetet e kryera sipas kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht nëse ato janë anuluar ose niveli i klasifikimit të sigurisë që ato ofrojnë akses është ulur.

3. Sipas kërkesës, autoritetet kompetente të sigurisë së Palëve, duke marrë parasysh legjislacionin e tyre përkatës të brendshëm, asistojnë njëri-tjetrin gjatë procedurave të verifikimit me qëllim që të lëshohen certifikata



sigurie personeli dhe certifikata e sigurisë industriale për shtetasit e tyre që banojnë ose strukturat që ndodhen në territorin e Palës tjetër.

4. Me qëllim që të arrihen dhe të ruhen standardet e krahasueshme të sigurisë, autoritetet kompetente të sigurisë, me kërkesë, i japin njëri-tjetrit informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikatat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të Pala përkatëse. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente të sigurisë mund të bien, gjithashtu, dakord për vizita reciproke.

5. Nëse është e nevojshme, autoritetet kompetente të sigurisë mund të lidhin marrëveshje sigurie për aspekte teknike specifike në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

6. Shërbimet e sigurisë të Palëve mund të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion operativ dhe/ose të fshehtë drejtpërdrejt në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

Neni 11 Vizitat

1. Vizitat që mundësojnë akses në informacionin e klasifikuar, për shtetasit e shtetit të një Pale në territorin e shtetit të Palës tjetër, i nënshtrohen pëlqimit paraprak me shkrim të autoriteteve kompetente të sigurisë ose për to bihet dakord ndryshe ndërmjet tyre.

2. Kërkesa për vizitë paraqitet nëpërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë të paktën njëzet ditë para vizitës. Në raste urgjente, kërkesa për vizitë i nënshtrohet bashkërendimit të drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë.

3. Kërkesa për vizitë përfshin:

a) emrin dhe mbiemrin, vendin dhe datën e lindjes, shtetësinë, numrin e pasaportës ose kartës së identitetit të vizitorit;

b) emrin e subjektit, strukturës ose organizatës që përfaqëson ose i përket vizitori;

c) emrin dhe adresën e subjektit, strukturës ose organizatës që do të vizitohet;

d) konfirmimin e certifikatës së sigurisë së personelit, vlefshmërinë e saj dhe nivelin e klasifikimit të sigurisë deri ku mund të ofrojë akses;

e) objektin dhe qëllimin e vizitës ose vizitave;

f) datën dhe kohëzgjatjen e pritshme të vizitës ose vizitave të kërkuara dhe në rastin e vizitave

periodike, duhet të përcaktohet periudha e plotë e mbuluar nga vizitat;

g) emrin dhe numrin e telefonit të pikës së kontaktit në subjekt, strukturën ose organizatën që do të vizitohet, kontaktet e mëparshme dhe çdo informacion tjetër të dobishëm për të përcaktuar justifikimin e vizitës ose vizitave;

h) datën, nënshkrimin dhe vulën zyrtare të autoritetit kompetent të sigurisë.

4. Autoriteti kompetent i sigurisë së Palës që merr kërkesën për vizitë njofton, në kohën e duhur, autoritetin kompetent të sigurisë së Palës kërkuese në lidhje me vendimin.

5. Nëse aprovohet vizita, autoriteti kompetent i sigurisë i Palës pritëse i jep një kopje të kërkesës për vizitë nëpunësit të sigurisë së subjektit, strukturës ose organizatës që do të vizitohet.

6. Vlefshmëria e autorizimit për vizitë nuk i kalon dymbëdhjetë muaj.

7. Për çdo kontratë/nëkontratë të klasifikuar Palët mund të bien dakord të përpilojnë lista me personat e autorizuar për të bërë vizita periodike. Këto lista janë të vlefshme për një periudhë fillestare prej dymbëdhjetë muajsh. Hollësitë e mëtejshme për vizitat periodike i nënshtrohen bashkërendimit të drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve të subjekteve të përfshira sipas termave dhe kushteve të miratuar.

8. Secila palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, sipas legjislacionit përkatës të brendshëm.

Neni 12 Kontratat e klasifikuara

1. Në rast se një prej Palëve ose subjekteve ligjore publike ose private të shtetit të saj synojnë të japin një kontratë/nëkontratë të klasifikuar që të kryhet brenda territorit të shtetit të Palës tjetër, Pala e shtetit ku kryhet përmbushja, merr përgjegjësi për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në lidhje me atë kontratë, në pajtim me legjislacionin e saj të brendshëm.

2. Me kërkesë, autoritetet kompetente të sigurisë konfirmojnë që kontraktorët e propozuar, si dhe individët që marrin pjesë në aktivitetet parakontraktuale ose në zbatimin e kontratave/nëkontratave të klasifikuara, kanë certifikata të përshtatshme sigurie industriale dhe certifikata të përshtatshme sigurie personeli.



3. Çdo kontratë/nënkontratë e klasifikuar e lidhur ndërmjet kontraktorëve të Palëve, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përfshin një aneks përkatës sigurie që identifikon aspektet e mëposhtme:

a) një listë të informacionit të klasifikuar në lidhje me kontratën/nënkontratën e klasifikuar dhe nivelet përkatëse të klasifikimit të sigurisë;

b) procedurën për komunikimin e ndryshimeve në nivelet e klasifikimit të sigurisë të informacionit të transmetuar;

c) kanalet dhe mjetet e komunikimit për transmetimin elektromagnetik;

d) procedurën për transportimin e informacionit të klasifikuar;

e) Autoritetet kompetente përgjegjëse për bashkërendimin e garantimit të informacionit të klasifikuar në lidhje me kontratën/nënkontratën e klasifikuar;

f) një detyrim për njoftimin e çdo shkeljeje faktike ose të dyshuar të sigurisë.

4. Një kopje e aneksit të sigurisë të çdo kontrate/nënkontrate të klasifikuar i kalohet autoritetit kompetent të sigurisë të palës ku duhet të përmbushet kontrata/nënkontrata, me qëllim që të lejohet mbikëqyrje dhe kontroll i përshtatshëm i sigurisë.

5. Çdo nënkontraktor duhet të përmbushë të njëjtat detyrime sigurie, si dhe kontraktori.

6. Autoritetet kompetente të sigurisë mund të bien dakord për vizita reciproke, me qëllim që të analizojnë eficiencën e masave të miratuara nga një kontraktor ose një nënkontraktor për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të përfshirë në një kontratë/nënkontratë të klasifikuar.

7. Kontratat/nënkontratat e klasifikuara të dhëna kontraktorëve që përfshijnë informacion të klasifikuar në nivelin I KUFIZUAR /RESTRICTED/SECRET DE SERVICIU përmbajnë një dispozitë të përshtatshme që identifikon masat minimale që duhet të zbatohen për mbrojtjen e këtij informacioni të klasifikuar.

8. Procedurat e mëtejshme të hollësishme në lidhje me kontratat/nënkontratat e klasifikuara zhvillohen dhe miratohen ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë së Palëve.

Neni 13

Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e një shkeljeje sigurie, autoriteti kompetent i sigurisë së Palës marrëse njofton menjëherë me shkrim autoritetin kompetent të sigurisë së Palës së origjinës dhe siguron hetimin e përshtatshëm. Nëse është e nevojshme, Palët bashkëpunojnë gjatë hetimit.

2. Në rast se shkelja e sigurisë ndodh në një shtet të tretë, autoriteti kompetent i sigurisë i Palës dërguese ndërmerr veprimet në pajtim me paragrafin 1.

3. Në çdo rast, autoriteti kompetent i Palës marrëse njofton me shkrim autoritetin kompetent të sigurisë së Palës së origjinës në lidhje me rrethanat e shkeljes së sigurisë, masën e dëmit, masat e marra për zbutjen e tij dhe rezultatin e hetimit. Ky njoftim përmban hollësi të mjaftueshme për Palën e origjinës të vlerësojë plotësisht pasojat.

Neni 14

Shpenzimet

Secila Palë mbulon shpenzimet e veta në pajtim me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Kjo mund të priset nga një Palë, duke i bërë Palës tjetër një njoftim paraprak me shkrim 6 (gjashtë) muaj para përfundimit.

3. Pavarësisht përfundimit të Marrëveshjes, i gjithë informacioni i klasifikuar i dhënë në pajtim me këtë Marrëveshje vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara këtu, derisa Pala e origjinës ta lirojë Palën marrëse nga ky detyrim.

4. Secila Palë njofton menjëherë Palën tjetër për çdo ndryshim në legjislacionin e saj të brendshëm që do të ndikonte në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ose të gjeneruar sipas kësaj Marrëveshjeje.



5. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet mbi bazën e me pëlqimin e përbashkët me shkrim të të dyja Palëve. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në pajtim me paragrafin 1.

6. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultime ndërmjet Palëve, pa iu drejtuar juridiksionit të jashtëm.

7. Aspekte të tjera teknike të bashkëpunimit mund të rregullohen me pëlqimin reciprok të Palëve.

Bërë në Bukuresht, më 14 nëntor 2013, në dy kopje origjinale, secila në shqip, rumanisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Shyqyri Dekavelli

Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

Autoriteti i Sigurimit Kombëtar

Për qeverinë e Rumanisë

Prof. Univ. Dr. Marius Petrescu

Sekretari i Shtetit

Drejtor i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Informacioneve Sekrete Shtetërore

DEKRET

Nr. 9048, datë 16.4.2015

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Frederik Koço Konini
2. Dorina Njac Konini (Doçi)
3. Valentina Aleksandër Selmani (Nimali)
4. Julia Spiro Dino

Faqe | 2804

5. Fatmir Haxhi Mema
6. Najada Ali Mema (Mullaj)
7. Lars Fatmir Mema
8. Anxhi Fatmir Mema
9. Bergita Mehmet Tanku (Beqiri)
10. Hilmi Qamil Buhaj
11. Sabahete Haxhi Buhaj (Demaj)
12. Avdi Arben Ferizoviqi
13. Anita Arben Ferizoviqi
14. Arrso Gjuro Matanaj
15. Jelena Mitro Matanaj (Malaj)
16. Denita Arjan Baholli
17. Melani Reshit Cika (Petrela)
18. Andi Giland Cika
19. Leonard Sulejman Hyka
20. Jete Kamer Čakarić (Beqiri)
21. Sonila Tufo Keminaj
22. Juna Keminaj
23. Julia Skënder Qelibari
24. Bajram Skënder Qelibari
25. Adria Jonna Skënder Qelibari
26. Regina Agron Qelibari
27. Dhurata Sabri Çaushaj (Sinani)
28. Chiara Anna Teme Çaushaj
29. Suzana Ramazan Hanke (Pisha)
30. Olsi Ligor Çifligu
31. Edlira Leonard Çifligu (Foto)
32. Lorena Olsi Çifligu
33. Xhoana Olsi Çifligu
34. Athina Isuf Fara (Hoxha)
35. Alpin Halo Habazaj
36. Merita Koçi Floqi (Andoni)
37. Blerta Zylfo Zerellari (Goxha)
38. Dominik Arian Zerellari
39. Nevila Bardhyl Kraja
40. Arlinda Resmi Çiftja (Fejzo)
41. Loren Bashkim Arrësi
42. Aurel Dhimitraq Qirjazi
43. Suada Vehbi Suçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

**DEKRET****Nr. 9049, datë 16.4.2015****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Branko Rado Zllatiçanin (Krstoja)
2. Edmonda Gligo Zllatiçanin (Pjetri)
3. Goran Branko Zllatiçanin (Krstoja)
4. Olta Albert Ballhysa
5. Enkelejda Qamil Sakollari (Qehajaj)
6. Aida Bajram Schneckenburg (Shametaj)
7. Pebeka Petrit Kasemi
8. Lindita Hamdi Ushaku (Topi)
9. Arion Agon Ushaku
10. Pavle (Pavlin) Pero (Prelë) Popoviq (Çekaj)
11. Julga Drago Popoviq (Mikuliq)
12. Valbona Bashkim Tila
13. Adela Hasip Çerma
14. Mladen Arrso Matanović (Matanaj)
15. Gzime Tahir Tafa
16. Sudisman Nuredin Hoxha
17. Clint Zamir Shpuza
18. Ervis Myslim Çollaku
19. Bledar Fadil Brahimaj
20. Sherife Arshi Bala
21. Isida Sheuqet Kreuzer (Toska)
22. Rexhina Avni Tahiri
23. Rexhep Avni Tahiri
24. Milan Spaso Krstoviq (Nikollaj)
25. Sllagjan Millan Martinoviq
26. Ilir Ismet Muça
27. Gëzim Isa Dani
28. Majlinda Abdurahim Wiesbauer (Kërleshi)
29. Besnike Sefer Isak (Lazi)
30. Elvis Selim Pashaj
31. Renata Bashkim Xibraku (Kuçi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET**Nr. 9050, datë 16.4.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Arbër Rasim Likaj
2. Rilind Shefqet Kastrati
3. Ajete Adem Veselaj
4. Yüksel Mehmet Çinar
5. Albion Qaush Avdijaj
6. Blerim Xhaferr Rryçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë